# DËSHMI ARKIVI

**A-440326**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kriza/ 'Presidenti' mban peng institucionet në Kosovë, Kurti zbulon lëvizjen e radhës: Jemi në bisedime, zgjedhjet nuk janë zgjidhje |
| ADRESA | `https://tpz.al/kriza-presidenti-mban-peng-institucionet-ne-kosove-kurti-zbulon-levizjen-e-radhes-jemi-ne-bisedime-zgjedhjet-nuk-jane-zgjidhje-i332347` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 18:47:18 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 8 shtator 2026, 10:50:56 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 6418ee4ecbb15988a79a023c86276a9d2ca624909b99cc395daff47862ed5401 |
| TEKSTI | 93766804725a5bf4d709d767c99db324061877c1d4a96f557aaf9d7c209564e0 |
| PAMJA | e3ca86eef29b273f09a4f278a8ecddfd1a5fa203c6e745c4915fe131b4e2edca |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | de266ef9dc2f35ddccf69dab5556f034fa2145a056bee5b9040714e505ccaba8 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/de266ef9dc2f35ddccf69dab5556f034fa2145a056bee5b9040714e505ccaba8`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BALLKAN, 8 SEPTEMBER 2026, 12:50

# Kriza/ 'Presidenti' mban peng institucionet në Kosovë, Kurti zbulon lëvizjen e radhës: Jemi në bisedime, zgjedhjet nuk janë zgjidhje

TPZ



Gjetja e një kandidature të përbashkët për presidentin vijon të mbajë peng konstituimin e Kuvendit dhe zhbllokimin e institucioneve në Kosovë. Edhe pse Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës arritën më 31 gusht një marrëveshje për të propozuar Bekim Sejdiun për president, kandidatura e tij ende nuk e ka mbështetjen e nevojshme, pasi gjashtë deputetë të LDK-së e kundërshtojnë, ndërsa PDK dhe Aleanca nuk kanë pranuar ta mbështesin.

Sot, kryeministri në detyrë dhe kreu i LVV-së, Albin Kurti, pranoi se kontaktet mes partive politike po vazhdojnë, me synimin për të arritur një marrëveshje që do të mundësojë zgjedhjen e presidentit dhe shmangien e zgjedhjeve të reja.

"Vazhdojmë me takime, bisedime në mënyrë që ta zgjedhim presidentin dhe të mos kemi nevojë t'i përsërisim zgjedhjet që janë të paarsyeshme. Unë jam vazhdimisht me të tjerët, dhe besoj që duhet t'i shtroni pyetje atyre që po thonë që do ta bojkotojnë zgjedhjen e presidentit", tha Kurti.

Deklaratat e tij vijnë në prag të seancës së 9 shtatorit, të thirrur nga kryesuesi Avni Dehari, ku PDK dhe LDK kanë konfirmuar pjesëmarrjen. Seanca pritet të jetë një tjetër përpjekje për zhbllokimin e procesit të konstituimit të Kuvendit, i cili ka mbetur pezull për shkak të mungesës së një marrëveshjeje për zgjedhjen e presidentit.

Për zgjedhjen e kreut të shtetit kërkohet pjesëmarrja e të paktën 80 deputetëve në Kuvendin me 120 vende. LVV-ja ka 53 mandate, ndërsa LDK-ja 18, por kundërshtimi i gjashtë deputetëve të kësaj force politike e ka vënë në pikëpyetje marrëveshjen për Bekim Sejdiun. Nga ana tjetër, PDK, me 22 deputetë, dhe Aleanca, me shtatë, kanë refuzuar ta mbështesin kandidaturën.

Kosova drejtohet aktualisht nga ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, e cila mori detyrën pas përfundimit të mandatit të Vjosa Osmanit në prill. Sipas Kushtetutës, ajo mund ta ushtrojë këtë funksion deri më 4 tetor, ndërsa akti më i lartë juridik nuk përcakton se çfarë ndodh nëse deri atëherë vendi nuk zgjedh presidentin e ri.

ide!

John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?
Nga Thoma Gëllçi

"Liria punon", por duhen edhe 6 milionë dollarë!
Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

Moti
Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tjera video

BALLKAN / 8 September 2026, 10:02

## Ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla dënohet me 1 vit burgim me kusht për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës

BALLKAN / 7 September 2026, 22:28

## Avdullah Hoti kërkon lidership të ri në LDK: Shala kryetar, Bajrami kandidate për kryeministre

BALLKAN / 7 September 2026, 21:11

## Çfarë fshehin dosjet për demonstratat e '81-shit në Kosovë? Dëshmi të ndryshme për organizimin dhe rolin e Shqipërisë

BALLKAN / 7 September 2026, 21:01

## Edward Joseph: Serbia është platforma kryesore për ndikimin dashakeq rus dhe kinez në Ballkan

BALLKAN / 7 September 2026, 20:40

## Ratko Mladiq u përcoll me ceremoni shtetërore, BE dënon glorifikimin e kriminelëve të luftës

BALLKAN / 7 September 2026, 18:59

## Varrimi i Mlladiçit me nderime shtetërore, Sarajeva tërheq stafin e Ambasadës nga Serbia

BALLKAN / 7 September 2026, 18:11

## Vuçiç përgatit rokadën/ I kërkohet zyrtarisht që të shpërndajë parlamentin, do të kandidojë për kryeministër

BALLKAN / 7 September 2026, 17:10

## Hyri me armë zjarri brenda një studioje muzikore në Kosovë dhe kërcënoi pronarin. Gjesti i shpëton

burgut! Dënohet 2 vite me kusht dhe 6 mijë euro gjobë

BALLKAN / 7 September 2026, 16:48

Vëllai i vuri flakën krevatit të saj teksa flinte, humb jetën në spital e reja shqiptare

BALLKAN / 7 September 2026, 13:18

Dyshohet se u vra me armë/ Ëndërronte të bëhej mjek për të shpëtuar jetë, kush është 16-vjeçari që u gjet mbrëmë i vdekur pranë shtëpisë së tij

BALLKAN / 7 September 2026, 11:31

Në homazhe, Vulin, Daçiç e djali i Vuçiç/ Mlladiç varroset pranë së bijës, që u vetëvra me armën e tij! I çonte lule nga arratia

BALLKAN / 7 September 2026, 10:16

Radhë për homazhe, mijëra serbë në varrimin e Ratko Mlladiçit, në Beograd! Ja ku do të varroset kriminleli i luftës

BALLKAN / 7 September 2026, 09:55

Spiunët serbë, në veprim/ Informacion, burime, ndikim! Gjurmët e BIA-s në Kosovë

BALLKAN / 6 September 2026, 20:12

Serbia abstenoi për hartën e re në OKB, me arsyetimin se Kosova paraqitet si shtet i pavarur

BALLKAN / 6 September 2026, 17:21

“Freedom for the Liberators”

BALLKAN / 6 September 2026, 16:48

Tronditet shfaqja airore

pritet të shfaqet në Times Square, aktivitete në Kosovë e Hagë para verdiktit

"Athens Flying Week 2026" në Greqi, dy pilotë humbin jetën pas rrëzimit të Phantom F-4 (VIDEO)

BALLKAN / 6 September 2026, 12:29

Protesta masive në Kroaci, qytetarët kërkojnë pastrimin e një landfilli me mbetje të rrezikshme

BALLKAN / 6 September 2026, 10:35

Greqia dhuron 400 euro shtesë për pensionistët çdo vit, paga minimale do të bëhet 1 mijë euro

BALLKAN / 5 September 2026, 22:51

Mitsotakis shpall paketën e re ekonomike për Greqinë/ Rritje pagash, 400 euro për pensionistët dhe lehtësime fiskale

BALLKAN / 5 September 2026, 20:54

Aksidenti tragjik në Greqi i merr jetën regjisores 29-vjeçare, familjarët gati të realizojnë filmin e saj të fundit



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.